MOT' I 1 QERϬOR 1909. № 6.

# DITURIJA

E PƐRKOHƐϬME ϬQIP LITERARE БE DITURAKE

**DEL ИƐ HERƐ NƐ MUAJ**

*Dreqtoɳɛs*: Ⱡumo Skɛndo

MBAN:

Letrɛ s' ime mbese, Teto Tule. Ϭqipɛtarɛt e Italisɛ. — Kɛngɛ tɛ Ϭqipɛtarɛvet t' Italisɛ. — Eklipsetɛ. — Si ɛϭtɛ bɛrɛ bota. — Nga Istori e kafϭɛvet. — Vetɛtima, gɛmimi, rrufeja. — Andej-kɛtej — Pjesa ϭtɛpiake. — Bibliografi.



SELANIK

# DITURIJA

## LETRE S' IME MBESE.

*Çupa im' e daϭurε,*

Dasmεn tεnde e mora veϭϭ nga letr' e gat' e jot kuϭεrire. Ϭega q' erδ kεtu ηε javε mê parε, mε rrεfeu δe ajo ηε nga ηε si nganε tε tεra. Po i ϭkroj s' at' εme δ' e uroj me ηε letrε tε gatε qε po vε sot nε postε.

Ty, o çupa ime, o Kaçe e vogεlε, tε dεrgoj pϭtjeλε nε faqet tε kεsaj kartεs' sε barδε giδ urimet e mij δe giδε lutjet pεr fatbarδεsinε tεnde. E di se sa tε dua: ty tε kam paturε giδεηε si çupε, se ti mε ke δεnε giδε daϭurinε qε do tε mε kiϭ δεnε fεmija ime sikur tε mε kiϭ falurε Zoti. Pandaj ty tε dua si ηε çupε δe si ηε mbesε, δe do tε kupεtoϭ vetε sa keq mε vjen qε s' mε la ϭεndeti tε ndoδεϭa vetε nε dasmεt tεnde δe tε gεzohεϭa si mȧ donte zεmra.

Kur tε març kεtε letrε do keç ηezet dit qε je zoηε ϭtεpije. Martesa pεr ηε grua εϭtε lindj' e dytε a mê mirε lindj' e vεrtetε pεr tê, se jeta pεr gruan' nis qε kur mer vεndin' e saj nε mes tε ηerεzisε, qε kur δemelon ηε ϭtεpi.

Sot mê s' jan' ata zakonε tε moçmε. Nε kohε t' ime nuseja 'me javε δe me muaj s' kiϭ tε dreqtε tε nxjerε zεnε. Tani kεto mê s' janε, nusja bεhetε zoηε ϭtεpije sa po hyn nε ϭtεpi tε burrit δe q' ahere zεnε detyrat e saj : detyr' e ηerεzisε δ' e ϭtεpisε.

Ϭtεpija εϭtε mbretεrí e gruasε: ϭtεpija εϭtε e tεrε bota pεr gruanε. Бε aϭtu sikundrε qε qeveritar a mbret' i ηε vεndi ka ηε barrε tε rεndε pεr tε qeverisurit e ηε mbretεrije, aϭtu δe gruaja barrεn e ka δe mbase mê tε rεnd' akoma.

E di fort mirε, Kaçe e daϭurε, se je rriturε mirε δe ke marrε stεrvitje tε bukurε. E di fort mirε se ke vetijε tε mirε, se ϭkon mirε me giδε botεnε.

„Sa di i pεsuari s' di i mεsuari" δotε fjala. Eδe un' nε kεta tε gaϭtδjet e pesε vjet e mij kam sa-do-mos disa mεsime.

Dij-e mirε, çupa ime, se nε kεtε jetε fatbarδεsinε si δe fatkeqεsinε ηeriu e mbryn me dorε tε tij. Vetija qε ka e bεn ηerinε tε lumtur a tε mjerε.